



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 135

Tiranë – E premte, 26 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 56/2026, datë 4.6.2026	Për nënproduktet me origjinë shtazore..... 12341
Dekret i Presidentit nr. 359, datë 23.6.2026	Për shpallje ligji..... 12364
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 119, datë 15.6.2026	Për delegimin e kompetencës drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojekti ‘Qendra e Shërbimeve Publike Palasë’”..... 12365
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 121, datë 17.6.2026	Për delegimin e kompetencave..... 12365
Urdhër i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 122, datë 17.6.2026	Për delegimin e kompetencave..... 12366
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 191/13, datë 23.6.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Sistemim rrugësh, blloku Përroi i Caprazit, Pogradec’”..... 12366



LIGJ
Nr. 56/2026

PËR NËNPRODUKTET ME ORIGJINË
SHTAZORE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të shëndetit publik e të shëndetit të kafshëve për nënproduktet me origjinë shtazore dhe për produktet derivate.

2. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe minimizimi i risqeve për shëndetin publik e për shëndetin e kafshëve, që rrjedhin nga këto produkte, dhe në veçanti për të mbrojtur sigurinë e zinxhirit ushqimor dhe të ushqimeve për kafshë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për:

a) nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate, të cilat janë përjashtuar nga konsumi për njerëzit sipas rregullave të këtij ligji;

b) produktet të cilat pas vendimit përfundimtar të marrë nga operatori i biznesit ushqimor nuk përdoren më si ushqim për njerëz, ku përfshihen:

i. produkte me origjinë shtazore, që ishin të destinuara për konsum nga njerëzit, sipas kërkesave të legjislacionit për ushqimin;

ii. lëndë të para për prodhimin e produkteve me origjinë shtazore.

2. Ky ligj nuk zbatohet për nënproduktet me origjinë shtazore, si më poshtë:

a) kadavra të plota ose pjesë të kafshëve të egra, të ndryshme nga kafshët e gjuetisë, të cilat nuk dyshohet të jenë të infektuara ose të prekura nga sëmundje të transmetueshme tek njerëzit ose tek kafshët, me përjashtim të kafshëve të ujit të zëna për qëllime tregtare;

b) kadavra të plota ose pjesë të kafshëve të gjuetisë, të cilat pas vrasjes nuk janë mbledhur, në përputhje me praktikat e mira të gjuetisë, pa rënë ndesh me legjislacionin përkatës në fushën e higjienës së ushqimeve me origjinë shtazore;

c) nënproduktet me origjinë shtazore, që rrjedhin nga kafshët e egra dhe nga mishi i kafshëve të egra;

ç) ovocitet, embrionet dhe sperma të destinuara për riprodhim;

d) qumështi i papërpunuar, kulloshtira dhe produktet që rrjedhin nga ato të përfituara, të ruajtura, të eliminuara ose të përdorura në fermën e origjinës;

dh) guackat e mburojat kockore të molusqeve, të cilave u janë hequr indet e buta dhe mishi;

e) mbetjet bio, përjashtuar mbetjet:

i. që vijnë nga mjetet e transportit, që kanë kryer udhëtime ndërkombëtare;

ii. e destinuara për t'u përdorur si ushqim për kafshë;

iii. e destinuara për sterilizim nën presion, për transformim nëpërmjet metodave të përshkruara nga shkronja "b", e pikës 1, të nenit 15 të këtij ligji për transformim në biogas ose kompostim;

ë) materialet që vijnë nga anijet e peshkimit që përmbushin kërkesat e legjislacionit për higjienën e ushqimeve e të ushqimeve me origjinë shtazore, të cilat përpunojnë peshkun e zënë gjatë lundrimit dhe hidhen në det, duke respektuar legjislacionin për mjedisin, përjashtuar materialet që rrjedhin nga pastrimi (eviscerimi) i peshkut në bordin e anijes dhe që shfaqin shenja të një sëmundjeje të transmetueshme te njerëzit, përfshirë edhe parazitozat;

¹ Ky ligj përafrohet pjesërisht me: Rregulloren (KE) nr. 1069/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 tetor 2009, "Për përcaktimin e rregullave shëndetësore, në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produktet derivate të tyre, të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga

njerëzit dhe që shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1774/2002 (Rregullorja për nënproduktet shtazore)", e ndryshuar. Numri CELEX 32009R1069, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 300, datë 14.11.2009, faqe 1–33.



f) ushqime të papërpunuara për kafshët e shoqërimit, që vijnë nga bizneset e shitjes me pakicë, ku mishi pritët dhe magazinohet vetëm për qëllimin e shitjes të konsumatori direkt në vend;

g) ushqime të papërpunuara për kafshët e shoqërimit, që rrjedhin nga kafshë të therura në fermën e origjinës dhe të destinuara për konsum personal;

gj) jashtëqitjet e urina, me përjashtim të plehut të stallës dhe plehu (glasat) i shpendëve i paminer-alizuar.

3. Ky ligj zbatohet pa rënë ndesh me legjislacionin në fushën e veterinarisë, që synon kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve.

Neni 3 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë ligj kanë këto kuptime:

1. “Nënprodukte me origjinë shtazore” janë trupa të plotë ose pjesë të trupit të kafshëve, produkte me origjinë shtazore ose produkte të tjera të përfituara nga kafshët, që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, përfshirë ovocitet, embrionet dhe spermën;

2. “Produkte derivate” janë produkte të përfituara nëpërmjet një ose më shumë trajtimeve, transformimeve ose fazave të përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore;

3. “Produkte me origjinë shtazore” janë produktet, si më poshtë:

a) ushqime me origjinë shtazore, përfshirë mjaltin dhe gjakun;

b) molusqet bivalvorë të gjallë, echinoderma të gjalla, tunikate të gjalla, gastropodet detare të gjalla dhe të destinuara për konsum nga njerëzit;

c) kafshë të tjera të cilat i ofrohen konsumatorit të gjalla.

4. “Karkasë” është trupi i një kafshe pas therjes dhe kryerjes së tualetit (pastrimit), sipas legjislacionit në fushën e higjienës së mishit e të produkteve të mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në mënyrë mekanike;

5. “Kafshë” është çdo lloj kafshe vertebrorë ose jovertebrorë;

6. “Kafshë mbarështimi” janë:

a) një kafshë e mbajtur, majmur ose e rritur nga njeriu dhe e përdorur për prodhimin e ushqimeve, leshit, gëzofit, puplave, lëkurëve ose çdo lloj

prodhimi tjetër të përfituar nga kafshët ose për qëllime të tjera mbarështimi;

b) njëthundrakët.

7. “Kafshë e egër” është një kafshë, e cila nuk mbahet nga njeriu;

8. “Kafshë shoqërimi” është çdo kafshë që i përket një lloji kafshe, e cila zakonisht mbahet dhe ushqehet nga njeriu për qëllime të tjera nga mbarështimi, por që nuk konsumohet nga njeriu;

9. “Kafshë e ujit” është çdo kafshë e ujit sipas përcaktimeve të ligjit për shëndetin e kafshëve;

10. “Autoriteti kompetent qendror” është drejtoria përgjegjëse për politikën veterinarë në ministrinë që mbulon fushën e veterinarisë, përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, politikave veterinarë dhe të çdo veprimtarie tjetër, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit veterinar në fuqi;

11. “Operator” është personi fizik ose juridik, që zotëron nënprodukte me origjinë shtazore dhe/ose derivatet e tyre, përfshirë transportuesit, tregtarët dhe përdoruesit;

12. “Përdorues” është personi fizik ose juridik, që përdor nënprodukte me origjinë shtazore dhe produkte derivate për ushqimin e kafshëve, të cilat mbarështohen për përdorim të veçantë për qëllime kërkimore ose për qëllime të tjera të veçanta;

13. “Stabiliment” ose “impiant” është çdo vend, përjashtuar anijet e peshkimit, ku zhvillohet çdo lloj veprimtarie që sjell përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate;

14. “Vendosje në treg” është çdo veprimtari që ka si qëllim shitjen tek të tretët të nënprodukteve me origjinë shtazore, të produkteve derivate që rrjedhin nga përpunimi i tyre ose çdo lloj forme tjetër e furnizimit ndaj të tretëve, për arsye përfitimi apo falas ose që bën magazinim, me qëllim furnizimin e mëvonshëm të palëve të treta;

15. “Transit” është lëvizja nga një shtet i huaj në tjetrin përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore;

16. “Eksport” është lëvizja e nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe të derivateve të tyre në drejtim të një shteti tjetër;

17. “Encefalopatitë spongiforme të transmetueshme (TSE)” janë të gjitha encefalopatitë spongiforme të transmetueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit për TSE-të;



18. “Material specifik i rrezikshëm” është materiali specifik që paraqet rrezik sipas përcaktimeve të legjislacionit për TSE-të;

19. “Sterilizim nën presion” është trajtimi i nënprodukteve me origjinë shtazore pas copëtimit në copa jo më të mëdha se 50 mm, në një temperaturë më të lartë se 133°C në qendrën e copës më të madhe për të paktën 20 minuta pa ndërprerje, në një presion absolut të paktën 3 bar;

20. “Plehu i stallës” janë jashtëqitjet ose urina e kafshëve të mbarështimit me ose pa shtresën, përjashtuar peshqit e mbarështuar;

21. “Landfill i autorizuar” është një vend i autorizuar sipas kërkesave të legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve dhe për të cilin merret leje sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit;

22. “Fertilizant organik” dhe “Përmirësues toke” janë materiale me origjinë shtazore të përdorura së bashku ose të ndara për të ruajtur ose për të përmirësuar të ushqyerit e bimëve dhe vetitë fiziko-kimike të tokës e të aktivitetit biologjik të tyre, ku mund të përfshihet plehu i stallës, përmbajtja e traktit tretës, plehu i shpendëve (glasat) i pamineralizuar, produktet e kompostimit dhe mbetjet e të ushqyerit;

23. “Zonë e izoluar” është zona në të cilën dendësia e popullatës së kafshëve është shumë e ulët dhe ku stabilimentet ose impiantet e hedhjes së mbetjeve janë shumë larg nga njëra-tjetra dhe si pasojë kërkesat e nevojshme për mbledhjen ose transportin e nënprodukteve me origjinë shtazore do të ishin tepër të kushtueshme përkundrajt asgjësimit në vend;

24. “Ushqim” ose “Produkt ushqimor” është një ushqim ose një produkt ushqimor siç përcaktohet në legjislacionin për ushqimin;

25. “Ushqim për kafshë” është një ushqim për kafshët siç përcaktohet në legjislacionin për ushqimin;

26. “Mbetje e centrifugimit ose e ndarjes” është materiali i mbledhur si nënprodukt pas procesit të centrifugimit të qumështit të papërpunuar dhe të ndarjes së qumështit të skremuar e të kremës nga qumështi i papërpunuar;

27. “Mbetje” është mbetja sipas përcaktimit të legjislacionit për mjedisin;

28. “Mbetje me origjinë shtazore” nënkupton një nënprodukt me origjinë shtazore, të cilin zotëruesi e eliminon apo është i detyruar ta eliminojë, në

pamundësi përpunimi ose për shkak të detyrimit ligjor;

29. “Ministri” është ministri përgjegjës për fushën e veterinarisë;

30. “Autoritet kompetent për kontrollet zyrtare” është autoriteti përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e kontrolleve zyrtare e të veprimtarive të tjera zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për kontrollet zyrtare dhe inspektimin.

KREU II

ZINXHIRI I PRODHIMIT, DETYRIMIT DHE KUFIZIMIT

Neni 4

Pika e fillimit në zinxhirin e prodhimit dhe detyrimet

1. Operatorët, të cilët prodhojnë nënprodukte me origjinë shtazore ose derivate të tyre, që hyjnë në fushën e zbatimit të këtij ligji, përcaktojnë kategorinë e nënprodukteve, i regjistrojnë dhe marrin masa në mënyrë që të trajtohen në përputhje me këtë ligj (pika e fillimit).

2. Në të gjitha fazat e mbledhjes, transportit, menaxhimit, trajtimit, transformimit, përpunimit, magazinimit, vendosjes në treg, shpërndarjes, përdorimit dhe asgjësimit në biznesin që zotërojnë, operatorët marrin masa me qëllim që nënproduktet me origjinë shtazore dhe derivatet e tyre të respektojnë kërkesat e këtij ligji.

3. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kontrollon dhe verifikon respektimin e kërkesave përkatëse të këtij ligji nga ana e operatorëve gjatë të gjithë zinxhirit të nënprodukteve me origjinë shtazore e të derivateve të tyre, sipas kërkesave të pikës 2 të këtij neni. Për këtë qëllim operatorët mbajnë një sistem regjistrimi të kontrolleve zyrtare.

4. Shqipëria merr masa për vendosjen e një sistemi regjistrimi të përshtatshëm për të garantuar që nënproduktet me origjinë shtazore:

a) të mbledhen, të identifikohen dhe të transportohen pa vonesa të panevojshme;

b) të trajtohen, të përdoren ose të eliminohen në përputhje me këtë ligj.



Neni 5

Pika fundore në zinxhirin e prodhimit

1. Produktet derivate, sipas përshkrimeve të nenit 32 të këtij ligji, të cilat arrijnë në fazën e prodhimit, konsiderohen si produkte që kanë arritur pikën fundore të zinxhirit të prodhimit dhe nuk janë më objekt i kërkesave të këtij ligji. Këto produkte derivate mund të vendosen më pas në treg pa kufizime, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe nuk janë më objekt i kontroleve zyrtare, në përputhje me këtë ligj.

2. Pika fundore e zinxhirit të prodhimit mund të ndryshohet:

a) për produktet e përshkruara nga shkronja “a” tek shkronja “ç”, të nenit 32 të këtij ligji në rastin e risqeve për shëndetin e kafshëve;

b) për produktet e përshkruara në shkronjat “d” e “dh”, të nenit 32 të këtij ligji në rastin e risqeve për shëndetin publik ose të kafshëve.

3. Për produktet derivate, sipas neneve 31, 34 dhe 35 të këtij ligji, të cilat nuk paraqesin më risk për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve, mund të përcaktohet një pikë fundore në zinxhirin e prodhimit përtej së cilës nuk mund të jenë më subjekt i kërkesave të këtij ligji. Këto produkte derivate mund të futen më pas në treg pa kufizime të mëtejshme sipas kërkesave të këtij ligji dhe nuk mund të jenë më subjekt i kontroleve zyrtare, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 6

Kufizime të përgjithshme që rrjedhin nga shëndeti i kafshëve

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate, të cilat preken nga një sëmundje e listuar, nuk mund të lëvizin jashtë fermave, stabilimenteve, impianteve dhe zonave për të cilat janë vendosur masa kufizuese:

a) sipas kërkesave të ligjit në fushën e veterinarisë; ose

b) për shkak të pranisë së një sëmundjeje të transmetueshme të listuar sipas legjislacionit për shëndetin e kafshëve.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet kur nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate lëvizin me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme te njerëzit ose te kafshët.

KREU III

KATEGORIZIMI

Neni 7

Kategorizimi i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate

Nënproduktet me origjinë shtazore ndahen në kategori specifike, që pasqyrojnë nivelin e tyre të rrezikut për shëndetin publik të njerëzve ose të kafshëve, në përputhje me listat e hartuara, sipas kërkesave të neneve 8, 9 dhe 10 të këtij ligji. Produktet derivate u nënshtrohen rregullave për kategorinë specifike të nënprodukteve me origjinë shtazore nga të cilat janë përftuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 8

Materialet e kategorisë 1

Materialet e kategorisë 1 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore, si më poshtë:

a) kadavra të plota dhe të gjitha pjesët e trupit të kafshëve, përfshirë lëkurët e kafshëve të mëposhtme:

i. kafshë të dyshuara se janë të infektuara nga TSE-të (Encefalopatitë spongiforme të transmetueshme) ose kur prania e TSE-ve është e konfirmuar zyrtarisht;

ii. kafshë të eliminuara në kuadër të masave të çrrënjësjes së TSE-së;

iii. kafshë që nuk janë as kafshë mbarështimi apo kafshë të egra, si dhe kafshët e shoqërimit, kafshët e kopshteve zoologjike dhe kafshët e cirqeve;

iv. kafshë të përdorura në një procedurë ose në procedura të përcaktuara për mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore në rastet, ku autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vendos që kafshë të tilla ose pjesë të kadvrave të tyre mund të paraqesin risk për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, për pasojë të asaj ose atyre procedurave;

v. kafshë të egra nëse ka dyshim që janë të infektuara nga sëmundje të transmetueshme te njerëzit ose te kafshët;

b) materialet që:

i. paraqesin një risk specifik;

ii. janë kadavra të plota ose pjesë të tyre nga kafshë të ngordhura, të cilat përmbajnë materiale që paraqesin risk specifik në momentin e eliminimit;



c) nënprodukte me origjinë shtazore të përfituara nga kafshë, që u janë nënshtruar trajtimeve të paligjshme me produktet mjekësore veterinarë të ndaluara ose të paautorizuara;

ç) nënprodukte me origjinë shtazore, që përmbajnë mbetje të substancave të tjera farmakologjike dhe kontaminantët ambientale, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës, nëse mbetje të tilla tejkalojnë nivelet e lejuara nga legjislacioni përkatës në fuqi për mbetjet e substancave farmakologjike;

d) nënprodukte me origjinë shtazore të mbledhura gjatë trajtimit të ujërave të ndotura, sipas kërkesave për marrjen e masave, në përputhje me përkrahjet e shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 15 të këtij ligji:

i. nga stabilimente ose impiante, që përpunojnë materiale të kategorisë 1; ose

ii. nga stabilimente ose impiante në të cilat është hequr materiali i rrezikshëm specifik (TSE);

dh) mbetje ushqimore me prejardhje nga mbetjet e transportit ndërkombëtar;

e) përzierjet e materialeve të kategorisë 1 me materiale të kategorisë 2 ose 3.

Neni 9

Materiale të kategorisë 2

Materialet e kategorisë 2 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore, si më poshtë:

a) plehun e stallës, plehun e shpendëve të paminerizuar dhe përmbajtjen e traktit tretës;

b) nënproduktet me origjinë shtazore të mbledhura gjatë trajtimit të ujërave të ndotura sipas kërkesave për marrjen e masave, në përputhje me parashikimet e shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 15 të këtij ligji:

i. nga stabilimente ose impiante që përpunojnë materiale të kategorisë 2; ose

ii. nga thertore të ndryshme nga ato të përshkruara në shkronjën “d”, të nenit 8 të këtij ligji;

c) nënproduktet me origjinë shtazore që përmbajnë mbetje të substancave farmakologjike të autorizuar ose kontaminantë, por që tejkalojnë nivelet e lejuara sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet e substancave farmakologjike;

ç) produkte me origjinë shtazore që janë të deklaruar si të papërshtatshme për konsum nga njerëzit për shkak të pranisë së trupave të huaj në këto produkte;

d) produkte me origjinë shtazore të ndryshme nga materialet e kategorisë 1, që:

i. janë importuar, por nuk respektojnë legjislacionin veterinar për importimin tyre, me përjashtim të rasteve në të cilat legjislacioni lejon importin ose hyrjen e tyre, në përputhje me kufizime specifike ose kthimin e tyre në vendin e origjinës; ose

ii. janë të eksportuara, por nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara ose të autorizuar nga legjislacioni i shtetit importues, me përjashtim të rastit kur ato eksportohen me autorizim nga autoriteti kompetent i shtetit importues;

dh) kafshë ose pjesë të kafshëve të ndryshme nga ato të përshkruara nga neni 8 ose nga neni 10 i këtij ligji si më poshtë:

i. të cilat kanë ngordhur ose janë therur, të ndryshme nga ato për konsum nga njerëzit, ose janë eliminuar në kuadër të masave të çrrënjësjes së një sëmundjeje të caktuar;

ii. fetuset;

iii. ovocitet, embrionet dhe sperma, që nuk përdoren për riprodhim; dhe,

iv. zogjtë e shpendëve të ngordhur gjatë çeljes;

e) përzierjet e materialeve të kategorisë 2 me materiale të kategorisë 3;

ë) nënproduktet me origjinë shtazore që nuk janë materiale të kategorive 1 dhe 3.

Neni 10

Materiale të kategorisë 3

Materialet e kategorisë 3 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore, si më poshtë:

a) karkasa ose pjesë të kafshëve të gjahut të therura, karkasa të plota ose pjesë të karkasave të kafshëve të gjahut të vrara e të deklaruar, të përshtatshme për konsum nga njerëzit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin veterinar, legjislacionin në fuqi për ushqimin dhe legjislacionin në fuqi për gjahun, por që nuk janë më të destinuara për konsum nga njerëzit për arsye tregtare;

b) karkasa ose pjesë të cilat rrjedhin nga kafshë të therura në një thertore për konsum nga njerëzit pas kontrollit para therjes ose karkasa dhe pjesë të karkasave të kafshëve të gjahut të vrara për konsum nga njerëzit, si më poshtë:

i. karkasat ose pjesë të tyre të refuzuara, pasi nuk janë të përshtatshme për konsum nga njerëzit, në përputhje me legjislacionin për ushqimin, por që nuk



shfaqin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose për kafshët;

ii. kokat e shpendëve;

iii. lëkurët, përfshirë fragmentet ose copat e prera, brirët dhe thundrat, përfshirë këmbët e kockat karpale dhe metakarpale, kockat tarsale e metatarsale të kafshëve të ndryshme nga ruminantët, që i nënshtrohen testimit të detyrueshëm për TSE-në e të ruminantëve që i janë nënshtruar testimit për TSE-të me rezultat negativ;

iv. qimet e derrave;

v. puplat;

c) nënprodukte me origjinë shtazore nga shpendë dhe lagomorfë (familja e lepujve) të therur në fermë për konsum për njerëzit e që nuk kanë asnjë shenjë të sëmundjeve të transmetueshme të njerëzit ose të kafshët;

ç) gjaku i kafshëve pa shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme të njerëzit ose të kafshët nëpërmjet gjakut, i përfituar nga kafshët e therura në thertore, pasi janë konsideruar të përshtatshme për therje për konsum për njerëzit, pas kontrollit veterinar para therjes, që rrjedh nga:

i. kafshë të ndryshme nga ruminantët për të cilat kërkohet testimi i detyrueshëm për TSE-të;

ii. ruminantët që u janë nënshtruar testeve dhe që kanë dhënë rezultat negativ për TSE-të;

d) nënprodukte me origjinë shtazore, që rrjedhin nga prodhimi i produkteve të destinuara për konsum nga njerëzit, përfshirë mbetjet e përpunimit të dhjavit të kafshëve, kockave, të cilave u është hequr yndyra, mbetjet e centrifugimit ose mbetjet e përpunimit të qumështit;

dh) produkte me origjinë shtazore ose produkte ushqimore, që përmbajnë produkte me origjinë shtazore, të cilat nuk janë më të destinuara për konsum për njerëzit për arsye tregtare ose për probleme të shkaktuara gjatë prodhimit, ose defekte të paketimit dhe defekte të tjera, që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve;

e) ushqime me origjinë shtazore për kafshët e shoqërimin e për kafshë të tjera ose ushqime për kafshë, të cilat përmbajnë nënprodukte me origjinë shtazore, ose produkte derivate që nuk janë më të destinuara për përdorim në ushqimet e kafshëve për arsye tregtare ose për shkak të defekteve të prodhimit ose të paketimit apo defekte të tjera, që nuk paraqesin rrezik për shëndetin publik, ose të kafshëve;

ë) gjak, placenta, lesh, pupla, qime, brirë, fragmente të thundrave dhe qumësht i papërpunuar, që rrjedhin nga kafshë të gjalla e që nuk paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose për kafshët nëpërmjet këtyre produkteve;

f) kafshë të ujit dhe pjesë të tyre, përjashtuar gjitarët e detit, që nuk paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose për kafshët;

g) nënprodukte shtazore të kafshëve të ujit, që rrjedhin nga stabilimente ose nga impiante prodhimi të produkteve të destinuara për konsum nga njerëzit;

gj) materiale që rrjedhin nga kafshë pa shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme të njerëzit ose të kafshët nëpërmjet këtyre materialeve:

i. guackat ose mburojat kockore të krustaceve dhe molusqeve, që përmbajnë inde të buta ose mish;

ii. produktet që rrjedhin nga kafshët e tokës, të tilla si: nënprodukte nga inkubatorët, vezë, nënprodukte të vezëve, përfshi edhe lëvozhgat e vezëve;

iii. zogj njëditësh të eliminuar për arsye tregtare;

h) jovertebrorë të tokës dhe të ujit, të ndryshëm nga llojet patogjene për njerëzit ose për kafshët;

i) kadavrat ose pjesë të tyre që u përkasin kafshëve të rendeve të brejtësve (*Rodentia*) dhe të lepujve (*Lagomorpha*), përjashtuar materialet e kategorisë 1, sipas nënndarjeve “iii”, “iv” e “v”, të shkronjës “a”, të nenit 8 dhe të kategorisë 2, nga shkronja “a” tek shkronja “e”, të nenit 9 të këtij ligji;

j) lëkurë, thundra, pupla, lesh, brirë, qime të përfituara nga kadavra të kafshëve të ngordhura, pa asnjë shenjë klinike të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose për kafshët, nëpërmjet këtyre produkteve, të ndryshme nga ato të përshkruara në shkronjën “b” të këtij neni;

k) inde dhjamore, që rrjedhin nga kafshë pa shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose për kafshët nëpërmjet këtyre materialeve, të përfituara nga kafshë të therura në thertore dhe të konsideruara të përshtatshme për konsum nga njerëzit, në momentin e therjes pas kryerjes së kontrollit veterinar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit veterinar;

l) mbetje bio, të ndryshme nga ato të përshkruara në shkronjën “dh”, të nenit 8 të këtij ligji.



KREU IV
ELIMINIMI E PËRDORIMI I
NËNPRODUKTEVE ME ORIGJINË
SHTAZORE DHE I PRODUKTEVE
DERIVATE

Neni 11
Kufizimet e përdorimit

1. Ndalohet përdorimi i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate, për:

a) ushqyerjen e llojeve të caktuara të kafshëve të tokës, përjashtuar kafshët për prodhimin e gëzofëve, me proteina shtazore të përpunuara, të përfituara nga karkasa të plota të kafshëve ose pjesë të tyre të të njëjtit lloj;

b) ushqyerjen e kafshëve të mbarështuara, të ndryshme nga ato që përdoren për prodhimin e gëzofëve me mbetje bio ose me lëndë të para për ushqimet e kafshëve të përfituara nga këto mbetje ose derivate të tyre;

c) ushqyerjen e kafshëve të mbarështuara me bimë të egra në kullota ose pas mbledhjes së tyre në kullota, ku janë përdorur fertilizantë organikë ose përmirësues toke, të ndryshëm nga plehu i stallës, me përjashtim të rastit kur kullotja ose mbledhja e barit në ato kullota kryhet pas përfundimit të periudhës së pritjes prej të paktën 21 ditë nga përdorimi i tyre, me qëllim që të garantohet kontrolli i përshtatshëm i riskut, që ato paraqesin për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve;

ç) ushqimin e peshqve të mbarështuar me proteina shtazore të përpunuara, të përfituara nga karkasa ose pjesë të karkasave të peshqve të mbarështuar të të njëjtit lloj.

2. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare merr masa për sa u përket:

a) verifikimeve dhe kontrolleve zyrtare që kryhen për të garantuar zbatimin e masave ndaluese sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë metodat e analizave dhe provat që përdoren për të verifikuar praninë e materialeve që rrjedhin nga lloje të caktuara kafshësh e kufijtë e sasive të papërfillshme të proteinave shtazore të përpunuara, sipas shkronjave “a” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, të shkaktuara nga kontaminimi aksidental ose teknikisht i pashmangshëm;

b) kontrollit të kushteve të ushqyerjes së kafshëve për prodhimin e gëzofëve me proteina shtazore të

përpunuara, të përfituara nga karkasa ose pjesë të karkasave të kafshëve të të njëjtit lloj;

c) kontrollit të ushqyerjes së kafshëve të mbarështuara me bimë të egra që vijnë nga toka, ku janë përdorur fertilizantë organikë ose përmirësues toke, në veçanti një modifikim i periudhës së pritjes, sipas kërkesave të shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni.

Neni 12
Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 1

Materialet e kategorisë 1:

a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies (incenerimit):

i. direkt, pa përpunim paraprak; ose

ii. pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përherëshme;

b) kur janë mbetje, ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë (koincenerim):

i. direkt, pa përpunim paraprak; ose

ii. pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përherëshme;

c) eliminohen nëpërmjet procesit të sterilizimit nën presion, me markim të përherëshëm të materialit përfundimtar dhe groposjen në një landfill të autorizuar, atëherë kur bëhet fjalë për materiale të kategorisë 1, të ndryshme nga ato të përshkruara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “a”, të nenin 8 të këtij ligji;

ç) eliminohen nëpërmjet groposjes në landfill të autorizuar nëse bëhet fjalë për materiale të kategorisë 1, sipas shkronjës “dh”, të nenit 8 të këtij ligji;

d) përdoren si lëndë djegëse pas përpunimit ose pa përpunim paraprak;

dh) përdoren për prodhimin e produkteve derivate, të përshkruara në nenet 32, 34 dhe 35 të këtij ligji dhe vendosen në treg në përputhje me ato nene.



Neni 13

Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 2

Materialet e kategorisë 2:

a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies (incenerimit):

i. direkt, pa përpunim paraprak; ose

ii. pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përhershme;

b) kur janë mbetje, ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë (koincenerim):

i. direkt, pa përpunim paraprak; ose

ii. pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përhershme;

c) eliminohen në një landfill të autorizuar pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përhershme;

ç) përdoren për prodhimin e fertilizantëve organikë ose të përmirësuesve të tokës për t'i vendosur në treg, në përputhje me kërkesat e nenit 31 të këtij ligji, pas përpunimit nëpërmjet sterilizimit nën presion kur është e mundur dhe bëhet markimi i përhershëm i materialeve përfundimtare;

d) kompostohen ose transformohen në biogas:

i. pas sterilizimit nën presion dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përhershme; ose

ii. nëse bëhet fjalë për plehun e stallës, për traktin tretës dhe përmbajtjen e tij, për qumësht, produkte me bazë qumështi, kulloshtër, vezë dhe produkte të tyre, atëherë kur autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vlerëson se nuk ka risk për përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme, pas përpunimit paraprak ose pa përpunim paraprak;

dh) përdoren në tokë pa përpunim paraprak nëse bëhet fjalë për plehun e stallës, të përmbajtjes së traktit tretës, të ndarë nga trakti tretës, për qumësht, produkte me bazë qumështi dhe kulloshtër, nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vlerëson se nuk ka risk për përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme;

e) silazhohen, kompostohen ose transformohen në biogas nëse janë materiale që origjinojnë nga kafshët e ujit;

ë) përdoren si lëndë djegëse pas përpunimit ose pa përpunim paraprak;

f) përdoren për prodhimin e produkteve derivate të përshkruara në nenet 32, 33 dhe 35 të këtij ligji dhe vendosen në treg në përputhje me këto nene.

Neni 14

Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 3

Materialet e kategorisë 3:

a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies (incenerimit), me ose pa përpunim paraprak;

b) kur janë mbetje, ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë (koincenerim) me ose pa përpunim paraprak;

c) eliminohen në një landfill të autorizuar pas përpunimit;

ç) përpunohen, me përjashtim të materialeve të kategorisë 3, që kanë pësuar një proces dekompozimi ose kalbëzimi të tillë sa të paraqesin një risk të papranueshëm për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve nëpërmjet përdorimit të këtyre produkteve dhe që përdoren për prodhimin:

i. e ushqimeve për kafshët e mbarështuara, të ndryshme nga kafshët që përdoren për prodhimin e gëzofëve, të cilat vendosen në treg sipas nenit 30 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me materiale të përshkruara në shkronjat “j”, “k” dhe “l”, të nenit 10 të këtij ligji;

ii. e ushqimeve për kafshët e prodhimit të gëzofëve dhe që vendosen në treg, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji;

iii. e ushqimeve për kafshët e shoqërimit dhe që vendosen në treg, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji; ose

iv. e fertilizantëve organikë ose të përmirësuesve të tokës dhe që vendosen në treg, në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;

d) përdoren për prodhimin e ushqimeve të papërpunuara për kafshët e shoqërimit dhe që vendosen në treg, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji;

dh) kompostohen ose transformohen në biogas;

e) silazhohen, kompostohen ose transformohen në biogas nëse janë materiale që origjinojnë nga kafshët e ujit;



e) përdoren në kushte të përcaktuara nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare, të vendosura për të shmangur riskun për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, kur bëhet fjalë për guacka ose mburoja kockore të krustaceve e të molusqeve të ndryshme nga ato të përshkruara në shkronjën “dh”, të pikës 2, të nenit 2 dhe lëvizohet e vezëve;

f) përdoren si lëndë djegëse pas përpunimit ose pa përpunim paraprak; ose

g) përdoren për prodhimin e produkteve derivate të përshkruara në nenet 32, 33 e 35 të këtij ligji dhe vendosen në treg sipas kërkesave të këtyre neneve;

gj) përpunohen nëpërmjet sterilizimit nën presion ose nëpërmjet metodave të përshkruara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 15, kompostohen ose transformohen në biogas, nëse bëhet fjalë për mbetjet bio, sipas kërkesave të shkronjës “l”, të nenit 10; ose

h) përdoren në tokë pa përpunim paraprak nëse bëhet fjalë për qumështin e papërpunuar, kulloshtren e produkte me bazë qumështi dhe kulloshtre, nëse autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vlerëson se nuk ka risk për përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme.

Neni 15

Masat e zbatimit

1. Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, miraton masa të hollësishme për sa u përket:

a) kushteve të veçanta për përpunimin në bordin e anijeve dhe eliminimin e materialeve, që vijnë nga heqja e të brendshmeve (eviscerimi) të peshqve, të cilat paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme të njerëzit, përfshirë parazitozat;

b) metodave të përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore, të ndryshme nga metoda e sterilizimit nën presion, në veçanti për parametrat që zbatohen në kuadrin e këtyre metodave, sidomos kohëzgjatja, temperatura, presioni dhe madhësia e grimcave;

c) parametrave të transformimit të nënprodukteve me origjinë shtazore, përfshirë mbetjet e kuzhinës dhe të restorantit, në biogas e komposto;

ç) kushteve të djegies (incinerimit) dhe djegies për prodhimin e energjisë (ko-incinerimin) të

nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate;

d) kushteve të djegies së nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate;

dh) kushteve për prodhimin dhe trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore, sipas shkronjës “c”, të nenit 10 të këtij ligji;

e) silazhimit të materialeve që rrjedhin nga kafshët e ujit;

ë) markimit të përhershëm të nënprodukteve me origjinë shtazore;

f) përdorimit në tokë të disa nënprodukteve me origjinë shtazore, fertilizantëve organikë dhe të përmirësuesve të tokës;

g) përdorimit të disa nënprodukteve me origjinë shtazore për ushqyerjen e kafshëve të mbarështimit;

gj) nivelit të riskut për shëndetin publik dhe të kafshëve, i lidhur me disa materiale që konsiderohet si i papranueshëm, sipas përshkrimeve të shkronjës “ç”, të nenit 14 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 23, 24, 25 dhe 26 të këtij ligji, miraton masa të hollësishme për sa u përket:

a) kërkesave për strukturën dhe mjetet e punës në stabilimente ose në impiante;

b) rregullave në fushën e higjienës për të gjitha tipat e përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate, përfshirë rregullat që kanë si qëllim ndryshimin e kërkesave në fushën e higjienës për stabilimentet ose impiantet e përshkruara në pikën 1, të nenit 25 të këtij ligji;

c) kushteve dhe kërkesave teknike për përpunimin, trajtimin, transformimin, prodhimin e magazinimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate dhe kushtet për trajtimin e ujërave të kullimit;

ç) elementeve të provës, që operatori paraqet për të validuar (vërtetuar) trajtimin, transformimin dhe përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate, përkatësisht, për të shmangur risqet për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve;

d) kushteve për trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate të më shumë se një kategorie, sipas kërkesave të neneve 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, në të njëjtin stabiliment ose impiant, në të cilat:

i. këto veprimtari kryhen të ndara;

ii. këto veprimtari kryhen përkohësisht në rrethana të përcaktuara;



dh) kushteve për të parandaluar kontaminimin e kryqëzuar kur nënproduktet me origjinë shtazore magazinohen, trajtohen ose përpunohen në një pjesë të veçantë të një stabilimenti ose impianti, sipas kërkesave të nenit 26 të këtij ligji;

e) parametrave standarde të përpunimit për impiantet e prodhimit të biogazit dhe të kompostit;

ë) kërkesave që zbatohen për djegien (incenerimin) ose djegien për prodhimin e energjisë (koincenerimin) në impiante me kapacitet të ulët e të lartë, sipas kërkesave të shkronjave “b” e “c”, të pikës 1, të nenit 24 të këtij ligji;

f) kërkesave që zbatohen për përdorimin si lëndë djegëse të nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 24.

3. Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37 dhe 38 të këtij ligji, miraton masa të hollësishme për sa u përket:

a) kushteve për vendosjen në treg të ushqimeve për kafshët e shoqërimit të importuara ose të ushqimeve për kafshët e shoqërimit të prodhuara, duke u nisur nga lëndë të para të importuara, që rrjedhin nga materialet e kategorisë 1, sipas kërkesave të shkronjës “c”, të nenit 8;

b) kushteve për prejardhjen e sigurt, lëvizjen e sigurt të materialeve që do të përdoren, me kusht parandalimin e risqeve për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve;

c) dokumentacionit, sipas kërkesave të pikës 2, të nenit 36 të këtij ligji;

ç) parametrave për procesin e prodhimit, sipas kërkesave të pikës 1, të nenit 37, në veçanti për sa i përket zbatimit të trajtimeve fizike ose kimike për materialin e përdorur;

d) përskrimeve që u përkasin provave që bëhen për produktin përfundimtar;

dh) kushteve për përdorim të sigurt të produkteve derivate, që paraqesin një risk për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve.

KREU V PËRJASHTIME

Neni 16 Përfashtime

Në përjashtim nga nenet 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, nënproduktet me origjinë shtazore mund të eliminohen dhe të përdoren, si më poshtë:

a) nënproduktet me origjinë shtazore, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 15, mund të përpunohen dhe të eliminohen, në përputhje me kushtet e veçanta të përcaktuara sipas kërkesave të kësaj shkronje;

b) nënproduktet me origjinë shtazore, të cilat mund të përdoren për qëllime kërkimore ose për qëllime të tjera të veçanta, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;

c) nënproduktet me origjinë shtazore, sipas nenit 18 të këtij ligji, të përdorur për qëllime të veçanta në ushqime për kafshë, në përputhje me këtë nen;

ç) nënproduktet me origjinë shtazore, sipas nenit 19 të këtij ligji, eliminohen në përputhje me atë nen;

d) nënproduktet me origjinë shtazore mund të eliminohen ose të përdoren nëpërmjet metodave alternative të autorizuar, në përputhje me nenin 20 të këtij ligji, bazuar në parametra që mund të parashikojnë sterilizimin nën presion ose kërkesa të tjera të këtij ligji ose të masave përkatëse në zbatim të tij;

dh) materialet e kategorive 2 e 3, pasi të merret autorizimi i autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, përdoren në përgatitjen dhe hedhjen në tokë të preparateve biodinamike, sipas ligjit për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre;

e) materialet e kategorisë 3, pasi të merret autorizimi i autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, përdoren për ushqimin e kafshëve të shoqërimit;

ë) nënproduktet me origjinë shtazore, me përjashtim të materialeve të kategorisë 1, të përfituara gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale në kafshët e gjalla ose gjatë pjelljes së kafshëve në fermë, eliminohen direkt në fermë pas marrjes së autorizimit nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare.

Neni 17

Kërkimi shkencor dhe qëllime të tjera të veçanta

1. Në përjashtim nga nenet 12, 13 dhe 14 të këtij ligji, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mundet të autorizojë përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate në ekspozita, aktivitete artistike, për qëllime diagnostike, mësimore ose kërkimi, në zbatim të kushteve të përshtatshme, që kontrollojnë riskun



për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve. Këto kushte përfshijnë të paktën:

a) ndalimin e çdo lloj përdorimi të mëvonshëm për qëllime të tjera të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate;

b) detyrimin e eliminimit të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate në mënyrë të sigurt ose ridërgimin, kur është e mundur në vendin e origjinës.

2. Në rast kur ka risk për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve, që kërkojnë marrjen e masave për të gjithë territorin, në veçanti kur bëhet fjalë për risqe që sapo janë shfaqur, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mundet të përcaktojë kushte të dakordësuara për importin dhe përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate, sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni. Këto kushte mundet të përfshijnë rregulla që u përkasin magazinimit, ambalazhimit, identifikimit, transportit dhe eliminimit.

Neni 18

Përdorime të veçanta për ushqimin e kafshëve

1. Në ndryshim nga parashikimet e neneve 13 e 14 të këtij ligji dhe në respekt të kushteve që garantojnë kontrollin e riskut për shëndetin publik e të kafshëve, autoriteti kompetent i kontrolleve zyrtare mund të autorizojë mbledhjen dhe përdorimin e materialeve të kategorisë 2, me kusht që të mos rrjedhin nga kafshë të eliminuara ose të ngordhura si pasojë e pranisë së dyshuar ose të diagnostikuar të një sëmundjeje të transmetueshme te njerëzit ose te kafshët, si dhe të materialeve të kategorisë 3, për ushqimin:

a) e kafshëve të kopshtit zoologjik;

b) e kafshëve të cirkut;

c) e zvarranikëve dhe zogjve të gjahut, që nuk janë kafshë të kopshtit zoologjik ose të cirkut;

ç) e kafshëve për prodhimin e gëzofëve;

d) e kafshëve të egra;

dh) e qenve në strehat e grumbullimit të tyre ose të qenve të gjahut;

e) e qenve dhe të maceve në streha grumbullimi të miratuara;

ë) e larvave dhe të krimbave të destinuara të përdoren si karrem për peshkim.

2. Në ndryshim nga neni 12 i këtij ligji dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të

këtij neni, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mund të autorizojë:

a) përdorimin e materialeve të kategorisë 1, sipas nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji dhe të materialeve derivate nga kafshë të kopshtit zoologjik për ushqimin e kafshëve të kopshtit zoologjik;

b) përdorimin e materialeve të kategorisë 1, sipas nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji, për ushqimin e zogjve nekrofagë të llojeve të mbrojtura ose të kërcënuara nga zhdukja dhe të llojeve të tjera që jetojnë në habitatin natyral, me qëllim promovimin e biodiversitetit.

3. Në masat për zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare përcakton kushtet:

a) që u përkasin transportit, magazinimit dhe përdorimit të materialeve të kategorive 2 e 3, në të cilat mundet të autorizohet mbledhja dhe përdorimi i tyre, me qëllim ushqimin e kafshëve, sipas përkrahimeve të pikës 1 të këtij neni, edhe në prani të risqeve që sapo janë shfaqur;

b) në të cilat në disa raste, në ndryshim nga detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 21 të këtij ligji, mundet të autorizohet përdorimi si ushqim për kafshë i materialeve të kategorisë 1 sipas përkrahimit në pikën 2 të këtij neni, që përfshin:

i. llojet e mbrojtura apo të kërcënuara nga zhdukja e zogjve nekrofagë ose të llojeve të tjera, që mund të ushqehen me këto materiale;

ii. masa të përshtatshme për të parandaluar risqet për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve.

Neni 19

Mbledhja, transporti dhe eliminimi

1. Në përjashtim nga parashikimet e neneve 12, 13, 14 dhe 21 të këtij ligji, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mund të autorizojë eliminimin nëpërmjet:

a) groposjes së kafshëve të shoqërimit dhe njëhundrakëve të ngordhur;

b) djegies dhe groposjes në vend ose nëpërmjet mënyrave të tjera, nën kontrollin e veterinarit zyrtar, me qëllim që të parandalojnë transmetimin e riskut për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, të materialeve të kategorisë 1, sipas përkrahimeve të nënndarjes “v”, të shkronjës “a” dhe të nënndarjes “ii”, të shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji, të materialeve të kategorive 2 dhe 3 në zona të izoluar;



c) djegies dhe groposjes në vend ose nëpërmjet mënyrave të tjera, nën kontrollin e veterinarit zyrtar, me qëllim parandalimin e transmetimit të riskut për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, të materialeve të kategorisë 1, sipas përshkrimeve të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 8 të këtij ligji, të materialeve të kategorive 2 dhe 3 në zona në të cilat praktikisht është e pamundur hyrja për arsye gjeografike, klimaterike ose për shkak të katastrofave natyrale të mundshme mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personelit të autorizuar për mbledhjen e karkasave ose hyrja bëhet e mundur vetëm duke përdorur mjete të veçanta për mbledhjen e tyre;

ç) mënyrave të ndryshme nga djegia ose nga groposja në vend, nën kontrollin e veterinarit zyrtar, për materialet e kategorive 2 dhe 3, që nuk paraqesin risk për shëndetin publik e të kafshëve, kur sasia e materialeve nuk kalon një volum të përcaktuar në një javë, e përcaktuar në lidhje me natyrën e aktiviteteve të zhvilluara dhe me llojet e kafshëve të origjinës së nënprodukteve me origjinë shtazore në fjalë;

d) djegies ose groposjes në vend, në kushte të përshtatshme për parandalimin e riskut të transmetimit të sëmundjeve të transmetueshme për shëndetin publik ose të kafshëve, të nënprodukteve me origjinë shtazore, të ndryshme nga materialet e kategorisë 1, sipas nënndarjes “i”, të shkronjës “a”, të nenit 8 të këtij ligji, në rastet e shpërthimit të një sëmundjeje me njoftim të detyrues, kur transporti në impiantin e miratuar më të afërt për përpunimin ose për eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore do të rriste riskun e përhapjes ose të shtrirjes së mëtejshme të një vatre të një sëmundjeje epizootike, e cila mund çojë në tejkalimin e kapacitetit eliminues së këtij impianti;

dh) djegies ose groposjes në vend, në kushte të përshtatshme për parandalimin e riskut të transmetimit të sëmundjeve të transmetueshme për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve, të bletëve dhe të produkteve të apikulturës.

2. Popullata e kafshëve të një lloji të caktuar në një zonë të izoluar, sipas shkronjës “b”, të pikës 1 të këtij neni, nuk tejkalon një përqendrim maksimal të caktuar të popullatës së kafshëve në të gjithë territorin.

3. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mban informacione të përditësuara, për sa u përket:

a) zonave që ata konsiderojnë të izoluar, për qëllimet e zbatimit të shkronjës “b”, të pikës 1 të

këtij neni, e arsyet e vlerësimit si zonë e izoluar, si dhe informacione të përditësuara që u përkasin ndryshimeve të mundshme të vlerësimit si zonë e izoluar;

b) autorizimeve të dhëna sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij neni, për sa u përket materialeve të kategorive 1 dhe 2.

4. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare merr masa për sa i përket:

a) kontrollit të kushteve, që kanë si qëllim të garantojnë kontrollin e riskut për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, në rastin e djegies dhe të groposjes në vend;

b) përcaktimit të përqindjes maksimale të popullatës së kafshëve, sipas kërkesave të pikës 2 të këtij neni;

c) përcaktimit të volumit të nënprodukteve me origjinë shtazore, në lidhje me natyrën e aktivitetit e të llojeve të origjinës, siç përshkruhet në shkronjën “ç”, të pikës 1 të këtij neni;

ç) listës së sëmundjeve, sipas shkronjës “d”, të pikës 1 të këtij neni.

Neni 20

Autorizimi i metodave alternative

1. Procedura për autorizimin e metodave alternative për përdorim ose asgjësim të nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve të derivuara mund të fillohet nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare, ose pas aplikimit nga pala e interesuar, që mund të përfaqësojë disa palë të interesuara.

2. Palët e interesuara i dërgojnë aplikimet e tyre pranë autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, ku do të vlerësohet brenda 2 muajve nga pranimi i aplikimit të plotë nëse aplikimi është në përputhje me formatin standard të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI

MBLEDHJA, TRANSPORTI, GJURMUESHMËRIA DHE LICENCIMI

Neni 21

Mbledhja dhe identifikimi në lidhje me kategoritë dhe transportin

1. Operatorët mbledhin, përcaktojnë kategorinë, regjistrojnë dhe transportojnë nënprodukte me



origjinë shtazore në kushtet e përshtatshme për të parandaluar riskun për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve.

2. Operatorët sigurojnë që gjatë transportit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate ato të shoqërohen me një dokument tregtar ose me një certifikatë shëndetësore veterinarë.

Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mund të autorizojë vetëm transportin e plehut të stallave pa dokument tregtar ose pa certifikatë shëndetësore veterinarë, në mes të dy pikave të vendosura në të njëjtën fermë ose në mes të fermave dhe përdoruesve të plehut brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Dokumentet tregtare dhe certifikatat veterinarë, që shoqërojnë nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate gjatë transportit përmbajnë të paktën informacionin për origjinën, kategorinë, destinacionin, sasinë, përshkrimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate, si dhe numrin e licencës. Megjithatë, për nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara të transportuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mund të autorizojë dhënien e informacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni përmes një sistemi alternativ.

4. Operatorët mbledhin, transportojnë dhe eliminojnë mbetjet e kuzhinës e të restorantit të kategorisë 3, në përputhje me legjislacionin e mbetjeve.

5. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent qendror, përcakton me urdhër modelet e dokumenteve, si më poshtë:

a) modele të dokumenteve tregtare, të nevojshme gjatë transportit të nënprodukteve me origjinë shtazore;

b) modele të certifikatave shëndetësore dhe kushtet që rregullojnë mënyrat sipas të cilave këto certifikata shoqërojnë nënproduktet me origjinë shtazore e produktet derivate gjatë transportit.

Neni 22

Gjurmueshmëria

1. Operatorët që dërgojnë, transportojnë ose marrin nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate mbajnë një regjistër të partive të ngarkesave dhe dokumentet ose certifikatat

shëndetësore përkatëse. Kjo pikë nuk zbatohet kur është dhënë një autorizim për transportin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate pa dokumente tregtare, ose certifikata shëndetësore, në përputhje me pikën 2, të nenit 21 të këtij ligji.

2. Operatorët e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mbajnë sisteme dhe procedura për të identifikuar:

a) operatorët e tjerë, të cilëve u kanë dhënë nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate;

b) operatorët nga të cilët kanë marrë nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate.

Këto informacione i vihen në dispozicion autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, me kërkesë të tij.

3. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent qendror, mund të përcaktojë rregullat për sa u përket:

a) informacioneve që i vihen në dispozicion autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare;

b) periudhës kohore të ruajtjes së këtyre informacioneve dhe dokumentacionit që lidhet me to.

Neni 23

Licencimi i operatorëve, i stabilimenteve ose i impianteve

1. Operatorët e stabilimenteve apo të impianteve, që grumbullojnë, transportojnë, trajtojnë, tregtojnë, magazinonë, eliminojnë nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate licencohen. Për t'u pajisur me licencë operatorët, duhet:

a) të aplikojnë për një licencë për të gjitha stabilimentet ose impiantet nën kontrollin e tyre që janë aktive në çdo fazë të gjenerimit, transportit, trajtimit, përpunimit, magazinimit, vendosjes në treg, shpërndarjes, përdorimit ose asgjësimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve të derivuara;

b) t'i transmetojnë autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare informacione, për:

i. kategorinë e nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate, që do të grumbullojnë, do të transportojnë, do të magazinonë, do të përpunojnë, do të tregtojnë, do të eliminojnë dhe do të përdorin;

ii. natyrën e veprimtarive që do të zhvillojnë me nënproduktet me origjinë shtazore ose me



produktet derivate, si dhe materialin fillestar që do të përdorin.

2. Operatorët i japin autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare informacione të vazhdueshme për të gjitha stabilimentet ose impiantet, sipas kërkesave të shkronjës “a”, të pikës 1 të këtij neni, përfshi çdo ndryshim thelbësor në aktivitetin ose në rastin kur ata mbyllin një stabiliment ose impiant.

3. Procedura e licencimit kryhet sipas këtyre rregullave:

a) pas marrjes së njoftimit nga ana e operatorit, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kryen një kontroll paraprak për verifikimin e impianteve dhe në vijim të rezultateve të kontrollit licencën operatorin ose refuzon licencimin, duke dhënë arsyet e moslicencimit. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare mund t'i japë operatorit detyra shtesë për plotësimin e kushteve të licencimit sipas legjislacionit në fuqi të licencave;

b) operatori pajiset me licencë sipas legjislacionit për lejet dhe licencat;

c) pas marrjes së licencës, operatori njofton autoritetin kompetent për kontrollet zyrtare për marrjen e aktit të licencës;

ç) pas marrjes së njoftimit se operatori është licencuar, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare kryen një kontroll të dytë me qëllim verifikimin e kushteve të licencimit, në përfundim të të cilit jep miratimin e fillimit të aktivitetit ose refuzimin me arsyet e mosmiratimit;

d) pas marrjes së miratimit, sipas shkronjës “ç” të kësaj pike, operatori njofton autoritetin kompetent për kontrollet zyrtare për fillimin e aktivitetit.

4. Licencimi i subjekteve bëhet sipas ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 24

Lejet për ushtrimin e veprimtarive të veçanta nga ana e operatorëve të licencuar

1. Operatorët marrin leje për stabilimentet ose impiantet e tyre tek autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare në rastet kur këto stabilimente ose impiante zhvillojnë një ose më shumë nga aktivitetet e mëposhtme:

a) trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore nëpërmjet sterilizimit nën presion, me metoda të transformimit, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të

nenit 15 ose metoda alternative sipas përshkrimeve të nenit 20 të këtij ligji;

b) eliminimin si mbetje nëpërmjet djegies së nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate, me përjashtim të stabilimenteve dhe impianteve që kanë leje për të vepruar, në përputhje me legjislacionin për incenerimin e mbetjeve;

c) eliminimin ose ripërdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore e produkteve derivate kur ato bëhen mbetje, nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë, përjashtuar stabilimentet ose impiantet, funksionimi i të cilave është autorizuar në përputhje me legjislacionin për incenerimin e mbetjeve;

ç) përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate si lëndë djegëse;

d) prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërim;

dh) prodhimin e fertilizantëve organikë dhe të përmirësuesve të tokës;

e) përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate në biogas ose kompost;

ë) përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore nëpërmjet veprimtarive, si: përzgjedhja, prerja, ftohja, ngrirja, kriposja, heqja e lëkurëve ose materialeve specifike të rrezikshme;

f) magazinimin e nënprodukteve me origjinë shtazore;

g) magazinimin e produkteve derivate të destinuara, që:

i. të eliminohen në landfill, digjen apo janë të destinuara të ripërdoren ose të eliminohen nëpërmjet djegies për prodhim të energjisë (koincerim);

ii. të përdoren si lëndë djegëse;

iii. të përdoren si ushqim për kafshë, përjashtuar stabilimentet ose impiantet e regjistruara apo të miratuara në përputhje me ligjin për ushqimin;

iv. të përdoren si fertilizantë organikë dhe përmirësuesit e tokës, përjashtuar magazinimin në vendin e përdorimit direkt si të tillë.

2. Dhënia e lejes sipas pikës 1 të këtij neni përcakton nëse stabilimenti ose impianti miratohet për veprimtari që u përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate, të:

a) një kategorie të veçante, sipas kërkesave të neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji; ose

b) një ose më shumë kategorive, sipas kërkesave të neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji, duke saktësuar nëse këto veprimtari zhvillohen:



i. në mënyrë të përhershme në kushtet e ndarjes së plotë të përpunimit të kategorive të ndryshme, me qëllim që të parandalojnë riskun e mundshëm për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve; ose

ii. në mënyrë të përkohshme në kushte që kanë si qëllim të parandalojnë kontaminimin, si pasojë e mungesës së mundësive dhe të kapaciteteve për këto produkte, si pasojë e një vatre të gjerë të një sëmundjeje epizootike ose rrethanave të tjera të jashtëzakonshme të paparashikuara.

KREU VII HIGJIENA

Neni 25

Kërkesa të përgjithshme në fushën e higjienës

1. Operatorët marrin masa që stabilimentet ose impiantet që zhvillojnë veprimtari sipas shkronjave “a” dhe “e”, të pikës 1, të nenit 24 të këtij ligji:

a) të jenë ndërtuar në mënyrë që të lejojnë pastrimin e dezinfektimin e përshtatshëm dhe, ku është e mundur, në mënyrë të tillë që planimetria të lehtësojë largimin e ujërave;

b) të kenë akses në struktura të përshtatshme për higjienën e personelit, si: banjë, dhoma zhveshjeje dhe lavamanë;

c) të kenë mjete të përshtatshme mbrojtëse kundër kafshëve të dëmshme, si: insekte, brejtës dhe zogj;

ç) të mirëmbajnë impiantët dhe mjetet e punës në kushte të mira e të sigurojnë që aparaturat e matjes të jenë të kalibruara rregullisht;

d) të kenë mjete të përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e kontenitorëve e të mjeteve të transportit për të evituar riskun e kontaminimit.

2. Të gjithë personat që punojnë në stabilimente ose në impiante sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të veshin rroba pune të përshtatshme, të pastra dhe, kur është e nevojshme, mbrojtëse.

Në impiant ose stabiliment:

a) punonjësit që kryejnë veprimtari në zona të pista nuk mund të hyjnë në zona të pastra para së të kenë ndërruar rrobat dhe këpucët e punës ose pasi t'i kenë dezinfektuar ato;

b) mjetet dhe veglat e punës nuk zhvendosen nga zona e pisët në zonën e pastër, nëse më parë nuk pastrohen dhe nuk dezinfektohen;

c) operatori përcakton një procedurë për zhvendosjen e personelit, me qëllim që të kontrollojë lëvizjet e të përshkruajë përdorimin e saktë të mjeteve të punës, larjen e këpucëve të punës dhe të rrotave të mjeteve.

3. Në stabilimente ose impiante që zhvillojnë aktivitet, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 24 të këtij ligji:

a) nënproduktet me origjinë shtazore përpunohen në mënyrë që të shmangët rreziku i kontaminimit;

b) nënproduktet me origjinë shtazore përpunohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Pas përpunimit, produktet derivate përpunohen dhe magazinohen në mënyrë që të shmangët rreziku i kontaminimit;

c) nëse nevojitet, gjatë përpunimit të një nënprodukti me origjinë shtazore dhe të një produkti derivat, të gjitha pjesët e nënproduktit me origjinë shtazore e të produktit derivat trajtohen në një temperaturë të caktuar për një periudhë kohe të caktuar për të shmangur riskun e kontaminimit;

ç) operatorët kontrollojnë rregullisht parametrat e zbatuar, në veçanti: temperaturën, presionin, kohën, përmasat e grimcave. Kur është e përshtatshme, kontrolli kryhet nëpërmjet aparaturave automatike;

d) përcaktohen dhe dokumentohen procedurat e pastrimit për të gjitha pjesët e stabilimentit ose të impiantit.

Neni 26

Përpunimi i nënprodukteve me origjinë shtazore nga operatorët e sektorit ushqimor

1. Trajtimi, përpunimi ose magazinimi i nënprodukteve me origjinë shtazore në stabilimente ose në impiante të licencuara e të lejuara, në përputhje me legjislacionin për higjienën e ushqimeve dhe atë të ushqimeve shtazore, bëhet duke respektuar kushtet, të cilat parandalojnë kontaminimin e kryqëzuar dhe, nëse nevojitet, në një pjesë të caktuar të stabilimentit ose të impiantit.

2. Lëndët e para për prodhimin e xhelatinës dhe të kolagenit, të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, mund të magazinohen, të përpunohen dhe të transformohen në stabilimente të licencuara e të lejuara në përputhje me legjislacionin për higjienën e ushqimeve dhe atë të ushqimeve shtazore, me kusht që risku i



transmetimit të sëmundjeve të parandalohet nëpërmjet ndarjes së këtyre lëndëve të para, të përdorura për prodhimin e produkteve me origjinë shtazore.

3. Përveç kërkesave, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, operatorët e përcaktuar në këtë nen zbatojnë edhe kërkesat specifike të parashikuara nga legjislacioni në fushën e veterinarisë.

KREU VIII KONTROLLET E BRENDSHME, ANALIZA E RISKUT DHE PIKAT KRITIKE TË KONTROLLIT (HACCP)

Neni 27

Vetëkontrolli

Operatorët hartojnë dhe zbatojnë rregullore të brendshme për kontrolle në stabiliment ose impiant, me qëllim monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Operatorët sigurojnë që asnjë nënprodukt shtazor ose produkt derivat për të cilin dyshohet ose është verifikuar se nuk përputhet me kërkesat e këtij ligji, të nxirret nga stabilimenti ose impianti, me përjashtim të rasteve kur do të bëhet eliminimi i tij.

Neni 28

Analiza e riskut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)

1. Operatorët që zhvillojnë një nga veprimtaritë e mëposhtme duhet të sigurojnë, të zbatojnë, të mbajnë dhe të ndjekin një procedurë të përhershme të shkruar ose procedura të mbështetura sipas parimeve të analizës së riskut e të pikave kritike të kontrollit (HACCP), për:

- a) përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore;
- b) transformimin e nënprodukteve me origjinë shtazore në biogas dhe kompost;
- c) përpunimin dhe magazinimin e një ose më shumë kategorive të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate në të njëjtin stabiliment ose impiant;
- ç) prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimit.

2. Operatorët e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni në veçanti:

a) identifikojnë të gjitha risqet që duhet të parandalohen, të eliminohen ose duhen zvogëluar në nivele të pranueshme;

b) identifikojnë pikat kritike të kontrollit në fazën ose fazat në të cilat vetëkontrolli është themelor për të parandaluar ose për të eliminuar një risk apo për ta ulur atë në nivele të pranueshme;

c) përcaktojnë kufijtë kritikë për pikat kritike të kontrollit, që ndajnë pranueshmërinë nga papranueshmëria, me qëllim parandalimin, eliminimin ose uljen e nivelit të riskut të identifikuar;

ç) përcaktojnë dhe zbatojnë procedura efektive të mbikëqyrjes në pikat kritike të kontrollit;

d) përcaktojnë masat korrigjuese që duhet të merren në rastet kur nga rezultatet e monitorimit rezulton që një pikë kritike e kontrollit nuk është në normë;

dh) përcaktojnë procedura për të verifikuar që masat e përshkruara nga shkronja “a” tek shkronja “d” të kësaj pike janë të përshtatshme dhe funksionojnë në mënyrën e duhur. Procedurat e verifikimit zhvillohen në mënyrë të rregullt;

e) përcaktojnë një dokumentacion dhe regjistra të përshtatshëm me natyrën dhe përmasat e biznesit në mënyrë që të tregojnë që masat janë zbatuar sipas kërkesave të përshkruara nga shkronja “a” tek shkronja “dh” të kësaj pike.

3. Çdo herë që bëhet një ndryshim në produkt, në proces ose në çdo fazë të prodhimit, të transformimit, të magazinimit ose të shpërndarjes, operatorët bëjnë ndryshimet e nevojshme dhe në procedura.

Neni 29

Manualet kombëtare të praktikave të mira

Autoriteti kompetent qendror vlerëson manualët kombëtare të praktikave të mira të punës, në veçanti për zbatimin e parimeve të HACCP-it, sipas kërkesave të nenit 28 të këtij ligji, me qëllim që të garantojë, që:

a) të jenë hartuar në këshillim me përfaqësues të operatorëve, të cilët mund të kenë interesa të përbashkëta dhe që të shpërndahen në sektorin e operatorëve përkatës;

b) të zbatohen në sektorët për të cilët janë hartuar.



KREU IX TREGTIMI

Neni 30 Vendosja në treg

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate, të destinuara për ushqimin e kafshëve që prodhojnë ushqime, të ndryshme nga kafshët për prodhimin e gëzofëve, mund të futen në treg me kushtin që:

a) të jenë ose të rrjedhin nga materiale të kategorisë 3, të ndryshme nga materialet e përcaktuara në shkronjat “j”, “k” dhe “l”, të nenit 10 të këtij ligji;

b) të jenë mbledhur ose të jenë trajtuar, sipas rastit, në përputhje me kushtet e përcaktuara për sterilizimin, nën presion ose në kushte të tjera të përshtatshme, që të parandalojnë risqet për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, në përputhje me masat e marra sipas kërkesave të nenit 15 të këtij ligji dhe të masave të mundshme të marra sipas kërkesave të pikës 2 të këtij neni;

c) të vijnë nga stabilimente ose impiante të licencuara sipas nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate për të cilat bëhet fjalë.

2. Masat e zbatimit të këtij neni mund të përcaktohen në lidhje me kushtet e shëndetit publik ose të shëndetit të kafshëve për mbledhjen, përpunimin dhe trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 31 Vendosja në treg dhe përdorimi i fertilizantëve organikë dhe i përmirësuesve të tokës

1. Fertilizantët organikë dhe përmirësuesit e tokës mund të futen në treg e të përdoren, me kusht që:

a) të rrjedhin nga materiale të kategorive 2 ose 3;

b) të jenë mbledhur ose të jenë trajtuar, sipas rastit, në përputhje me kushtet e përcaktuara për sterilizimin, nën presion ose në kushte të tjera të përshtatshme, që të parandalojnë risqet për shëndetin publik e shëndetin e kafshëve, në përputhje me masat e marra sipas kërkesave të nenit 15 të këtij ligji dhe të masave të mundshme të marra sipas kërkesave të pikës 3 të këtij neni;

c) të vijnë nga stabilimente ose impiante të licencuara;

ç) mielli i mishit dhe i kockave, të rrjedhura nga materiale të kategorisë 2 dhe i proteinave shtazore të përpunuara, të destinuara që të përdoren si fertilizantë organikë dhe pleh organik ose përbërës të tyre, të jenë përzier me një markues me qëllim që të parandalohet përdorimi i mëtejshëm i tyre në përzierje si ushqim për kafshë;

d) mbetjet që rrjedhin nga transformimi në biogas ose kompost të vendosen në treg dhe të përdoren si fertilizantë organikë ose përmirësues të tokës.

2. Në përjashtim nga shkronja “ç”, e pikës 1 të këtij neni, nuk është e nevojshme përzierja, kur përdorimi i tyre si ushqim për kafshë është përjashtuar si rezultat i përbërjes ose ambalazhimit të tyre.

3. Masat e zbatimit të këtij neni përcaktohen, për:

a) kushtet e shëndetit publik e të shëndetit të kafshëve për prodhimin dhe përdorimin e fertilizantëve e të përmirësuesve të tokës;

b) përbërësit dhe substancat për markimin e fertilizantëve organikë e për përmirësuesit e tokës;

c) përbërësit që do të përzihen me fertilizantët dhe përmirësuesit e tokës;

ç) kushtet shtesë, si metodat që duhet të përdoren për identifikimin dhe sasitë minimale që duhet të respektohen në përgatitjen e përzierjeve, me qëllim që të përjashtohet përdorimi i këtyre fertilizantëve dhe i përmirësuesve të tokës, si ushqime për kafshë;

d) rastet në të cilat përbërja ose ambalazhi lejojnë përjashtimin nga detyrimi i përzierjes së përbërësve.

Neni 32 Produktet derivate të rregulluara nga akte legjislative të tjera

Operatorët mund të vendosin në treg produktet derivate, si:

a) produkte kozmetike, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës për produktet kozmetike;

b) aparatura mjekësore të implantueshme aktive, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore;

c) aparatura mjekësore, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore;



ç) aparatura mjekësore diagnostike “*in vitro*”, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës për aparaturat mjekësore diagnostikuese “*in vitro*”;

d) produkte mjekësore veterinarë, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës të produkteve mjekësore veterinarë;

dh) barna, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës të barnave për përdorim nga njerëzit.

Neni 33 Prodhimi

1. Importimi, mbledhja dhe lëvizja e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate, të destinuara për stabilimentet ose impiantet për prodhimin e produkteve derivate, sipas përcaktimeve të nenit 32 të këtij ligji, dhe prodhimin e këtyre produkteve derivate, bëhen në përputhje me këtë ligj. Materialet e papërdorura që vijnë nga këto stabilimente ose impiante eliminohen në përputhje me rregullat e legjislacionit sektorial, sipas nenit 32 të këtij ligji.

2. Në ndryshim nga kërkesat e pikës 1 të këtij neni, zbatohen kërkesat e këtij ligji për eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore kur legjislacioni i përshkruar sipas nenit 32 të këtij ligji nuk përmbush kushtet e vendosura për parandalimin e riskut të mundshëm për shëndetin publik ose të kafshëve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 34 Vendosja në treg e ushqimeve për kafshët e shoqërimit

Operatorët mund të vendosin në treg ushqime për kafshët e shoqërimit, me kusht që:

a) këto produkte të rrjedhin nga:

i. materiale të kategorisë 3, të ndryshme nga materialet e përshkruara në shkronjat “j”, “k” dhe “p”, të nenit 10 të këtij ligji;

ii. ushqimet e kafshëve të shoqërimit të importuara ose nga ushqimet për kafshët e shoqërimit të prodhuara, duke u nisur nga lëndë të para të importuara, që rrjedhin nga materiale të kategorisë 1, sipas shkronjës “c”, të nenit 8, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga kërkesat e shkronjës “a”, të pikës 1 të nenit 39 të këtij ligji; ose

iii. ushqimet e kafshëve të shoqërimit të papërpunuara nga materialet e përshkruara në

shkronjën “a” dhe në nënndarjet “i” e “ii”, të shkronjës “b”, të nenit 10 të këtij ligji;

b) të sigurojnë kontrollin e riskut për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve nëpërmjet trajtimit të sigurt, në përputhje me kërkesat e nenit 37 të këtij ligji, kur kërkesat për një prejardhje të sigurt, sipas nenit 36 të këtij ligji, nuk garantojnë një mbrojtje të sigurt.

Neni 35 Vendosja në treg e produkteve të tjera derivate

Operatorët mund të vendosin në treg produkte derivate të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenet 30, 31, 32 dhe 34 të këtij ligji, me kusht që:

a) këto produkte:

i. të mos jenë të destinuara të përdoren si ushqim për kafshët, që prodhojnë ushqim, ose të përdoren direkt në toka të destinuara si kullota ose si livadhe për këto kafshë; ose

ii. të jenë të destinuara të përdoren si ushqim për kafshët për prodhimin e gëzofëve;

b) të sigurojnë kontrollin e riskut për shëndetin publik ose për shëndetin e kafshëve nëpërmjet:

i. prejardhjes së sigurt, në përputhje me nenin 36 të këtij ligji;

ii. trajtimit të sigurt, në përputhje me nenin 37 të këtij ligji, kur prejardhja e sigurt nuk garanton mbrojtje të mjaftueshme;

iii. verifikimit që produktet të jenë përdorur për qëllime përfundimtare të sigurta, në përputhje me nenin 38, kur trajtimi i sigurt nuk garanton mbrojtje të mjaftueshme.

Neni 36 Prejardhja e sigurt

1. Në kuadër të prejardhjes së sigurt përdoren materialet, që:

a) nuk paraqesin risk për shëndetin publik dhe të kafshëve;

b) janë mbledhur dhe janë transportuar nga pika e grumbullimit në stabilimentin ose në impiantin e përpunimit në kushte të përshtatshme, që bëjnë të mundur parandalimin e riskut për shëndetin publik e të kafshëve; ose

c) janë importuar dhe janë transportuar nga pika e hyrjes për në stabiliment ose në impiantin e përpunimit në kushte të përshtatshme që bëjnë të



mundur parandalimin e riskut për shëndetin publik e të kafshëve.

2. Për të garantuar prejardhje të sigurt operatorët mbajnë një dokumentacion, në përputhje me përshkrimet e pikës 1 të këtij neni, përfshirë, aty ku është e nevojshme, edhe prova për efikasitetin e masave të biosigurisë, të marra për të përjashtuar riskun, që paraqet materiali fillestar për shëndetin publik të njerëzve e të kafshëve.

Ky dokumentacion i vihet në dispozicion autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, me kërkesë të tij.

3. Në rastin e parashikuar nga shkronja “c”, e pikës 1 të këtij neni, partitë e mallit pajisen me një certifikatë shëndetësore sipas modelit të miratuar.

Neni 37

Trajtimi i sigurt

1. Trajtimi i sigurt përfshin zbatimin për materialet e përdorura të një procesi prodhimi, i cili bën të mundur uljen në një nivel të pranueshëm të riskut për shëndetin publik e të kafshëve nga materialet e përdorura dhe nga substanca të tjera, që rezultojnë nga procesi i prodhimit.

2. Trajtimi i sigurt garanton që produktet derivate të mos sjellin risk për shëndetin publik e të kafshëve, në veçanti duke kryer prova për produktin përfundimtar.

Neni 38

Përdorime përfundimtare të sigurta

Përdorimet përfundimtare të sigurta përfshijnë përdorimin e produkteve derivate:

a) në kushtet në të cilat produktet derivate nuk përbëjnë risk për shëndetin publik dhe për shëndetin kafshëve;

b) që mund të paraqesin risk për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve, por që përdoren për qëllime specifike, me kusht që përdorimi specifik të jetë i argumentuar në bazë të kërkesave të parashikuara në legjislacionin përkatës për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve.

KREU X

IMPORTI, TRANSITI DHE EKSPORTI

Neni 39

Importi dhe transiti

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate, që importohen ose që transitojnë nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësojnë:

a) kërkesat e këtij ligji dhe të masave të tjera zbatuese, që u përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe produkteve derivate, të cilat janë së paku po aq strikte sa ato që zbatohen për prodhim dhe tregtim të nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe produkteve derivate, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) kushtet që janë së paku ekuivalente me kërkesat e zbatueshme në prodhimin dhe tregtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate sipas legjislacionit në fuqi;

c) në rast të nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate, të përcaktuara në nenet 32, 34 dhe 35 të këtij ligji, kërkesat e përcaktuara në këto nene janë hartuar/përpiluar për plotësimin-ndryshimin e elementeve jothelbësore të këtij ligji.

2. Me përjashtim nga pika 1 e këtij neni, importi dhe transiti i:

a) materialit specifik të rrezikshëm trajtohet në përputhje me legjislacionin për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e disa encefalopative spongioforme të transmetueshme;

b) nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe produkteve derivate, të përziera ose të kontaminuara me ndonjë mbetje të listuar si të rrezikshme trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) materialit të kategorisë 1, materialit të kategorisë 2 dhe produkteve derivate nga to, të cilat nuk synohen për prodhimin e produkteve të derivuara, të përcaktuara në nenet 32, 34 dhe 35 të këtij ligji, do të lejohet vetëm në qoftë se rregullat për importin e tyre janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe produkteve derivate, të destinuara për qëllimet e përmendura në pikën 1, të nenit 17 të këtij ligji, kryhen në përputhje me masat kombëtare që sigurojnë kontrollin e rreziqeve për shëndetin publik dhe atë të kafshëve deri në miratimin e kushteve të



harmonizuara të përmendura në pikën 2, të nenit 17 të këtij ligji.

3. Në rastin e importit dhe transitit të materialit të kategorisë 3 dhe produkteve të derivuara prej tyre, kërkesat përkatëse, siç përcaktohen në shkronjën “a”, të pikës 1 të këtij neni, për të mundësuar specifikimin e dërgesave, duhet të:

a) vijnë nga një vend i BE-së ose nga një pjesë e një vendi tjetër të listuar në përputhje me pikën 4 të këtij neni;

b) vijnë nga stabilimente ose impiante të regjistruara ose të miratuara nga autoriteti kompetent i BE-së ose vendit të tretë të origjinës dhe të listuara në sistemin TRACE NT nga ky autoritet për këtë qëllim; dhe

c) shoqërohen në pikën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku kryhen kontrollet veterinare, me dokumentacion të tillë, si: dokument tregtar ose certifikatë shëndetësore dhe, kur është e përshtatshme, me një deklaratë që përputhet me një model në përputhje me masat implementuese.

4. Lista e vendeve të tjera ose pjesëve të vendeve të tjera nga të cilat nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate mund të importohen ose të kalojnë nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë përgatitet në përputhje me listën e shteteve dhe stabilimenteve të listuara në sistemin TRACE NT.

Neni 40

Eksporti

1. Ndalohet eksporti i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate të destinuara për djegie-incinerim ose landfill.

2. Ndalohet eksporti i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate drejt vendeve të tjera që nuk janë anëtare të OECD-së për përdorim në impiante biogazi ose kompostimi.

3. Materiali i kategorisë 1, materiali i kategorisë 2 dhe produktet derivate lejohen të eksportohen vetëm për qëllime të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1 dhe pikën 2 të këtij neni, me kusht që të jenë përcaktuar rregullat për eksportin e tyre.

4. Dispozitat përkatëse të ligjit të ushqimit, për rregullat e ushqimit dhe ushqimit të kafshëve zbatohen me ndryshimet përkatëse (*mutatis mutandis*) edhe për eksportin e materialit të kategorisë 3 ose

produkteve të prejardhura prej tij, në përputhje me këtë ligj.

5. Me përjashtim nga pika 3 dhe pika 4, eksporti i:

a) materialit specifik të rrezikshëm do të kryhet vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate ose të kontaminuara me çdo mbetje të listuar si e rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi.

KREU XI

KONTROLLE ZYRTARE DHE KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Procedura e miratimit dhe dhënies së lejeve

1. Miratimi i lejeve bëhet nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare vetëm pasi ai ka kryer një inspektim në vend para fillimit të çdo lloj aktiviteti nga i cili rezulton se janë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, të miratuara në zbatim të këtij ligji.

2. Operatorët sigurojnë ndërprerjen e aktivitetit në një stabiliment ose impiant, kur autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare i pezullon ose i heq atij miratimin apo lejen e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 42

Pezullimi dhe heqja e licencës

1. Nëse nga kontrollet zyrtare dhe nga inspektimet e kryera nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare rezulton se një ose më shumë kërkesa të këtij ligji nuk janë plotësuar, ky i fundit:

a) pezullon aktivitetin ose/dhe lejen/licencën e stabilimentit ose impiantit të miratuar bazuar në këtë ligj, nëse:

i. kushtet për dhënien e lejes/licencës ose për funksionimin e stabilimentit ose impiantit nuk janë përmbushur;

ii. vlerësohet që operatori nuk i ka plotësuar prej kohësh mangësitë e gjetura;

iii. risqet e mundshme për shëndetin publik dhe për shëndetin e kafshëve nuk kërkojnë marrjen e masave, të përshkruara në shkronjën “b” të kësaj pike;



b) propozon heqjen e licencës/lejes së stabilimentit ose impiantit të miratuar në zbatim të kërkesave të këtij ligji, nëse:

i. kushtet për miratimin ose funksionimin e stabilimentit ose të impiantit nuk përmbushen më;

ii. vlerësohet që operatori nuk do të jetë në gjendje të përmbushë mangësitë e gjetura brenda një kohë të arsyeshme, që janë të lidhura me infrastrukturën e stabilimentit/impiantit, me kapacitetet personale të operatorit ose të personelit që ai kontrollon, ose për shkak të risqeve të rënda për shëndetin publik ose të kafshëve, të cilat kërkojnë ndryshime të mëdha të funksionimit të stabilimentit/impiantit para se operatori të mund të paraqesë një kërkesë të re për leje/licencë;

c) urdhëron stabilimentin të përmbushë detyrime konkrete për të plotësuar mangësitë e gjetura.

Neni 43

Listat e stabilimenteve

1. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare harton dhe mban një listë të stabilimenteve, të impianteve dhe të operatorëve të licencuar ose të lejuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të lejeve e të licencave dhe e vendos atë në dispozicion të publikut në faqen zyrtare të tij.

2. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare i jep çdo stabiliment, impiant ose operatori një numër identifikimi zyrtar që i përket natyrës së aktiviteteve të tij.

KREU XII

MASAT ZBATUESE DHE

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 44

Regjistrat, certifikatat shëndetësore dhe listat e kontrollit të nënprodukteve me origjinë shtazore e të produkteve derivate

1. Nënproduktet me origjinë shtazore lëvizin brenda territorit, importohen dhe eksportohen vetëm nëse janë të pajisura me certifikatë shëndetësore të lëshuar nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare.

2. Ministri, me propozimin e autoritetit kompetent për kontrollet zyrtare, përcakton me urdhër modelet dhe përmbajtjen e certifikatës shëndetësore.

3. Modeli dhe përmbajtja e regjistrave e të protokoll-kontrolleve përcaktohet nga autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare.

Neni 45

Masa ndaluese

1. Është e ndaluar hedhja dhe eliminimi i nënprodukteve shtazore, i derivateve të tyre dhe i mbetjeve me prejardhje shtazore:

a) në vende që nuk janë autorizuar nga autoritetet kompetente;

b) në mjediset urbane: sheshe, rrugë, në kazanët e mblledhjes së mbetjeve urbane;

c) në det, në basene ujore natyrale e artificiale dhe në ledhe natyrale.

2. Ndalohet hedhja për qëllim eliminimin e të gjitha nënprodukteve me prejardhje nga kafshët e tokës dhe të gjitha nënprodukteve me prejardhje nga kafshët e ujit, me përjashtim të nënprodukteve që janë të përpunuara si ushqim për peshqit në basenet e mbarështimit të tij.

3. Është e ndaluar hedhja, groposja, braktisja dhe djegia e nënprodukteve shtazore në fusha, në kodra, në pyje dhe në çdo ambient tjetër rural.

4. Është e ndaluar braktisja e kadavrave të kafshëve të shoqërimit.

5. Është i ndaluar përdorimi i miellit të mishit dhe të kockave direkt në tokë, si fertilizantë organikë. Mielli i mishit dhe i kockave përdoret për prodhimin e fertilizantëve sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin e tyre.

Neni 46

Kontratat e bashkëpunimit

1. Operatorët e biznesit, të licencuar për mbarështimin e kafshëve, therjen e tyre, mbarështimin, përpunimin e peshkut dhe/ose tregtimin e tyre, me qëllim prodhimin e ushqimeve për njerëz, që janë ose përmbajnë produkte shtazore për konsum për njerëz, të cilët nuk i përpunojnë nënproduktet shtazore që ata krijojnë gjatë procesit të mbarështimit ose të prodhimit, përpara fillimit të aktivitetit për të cilin licencohen lidhin një kontratë me një grumbullues të nënprodukteve me origjinë shtazore, impiant ose stabiliment të licencuar për përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore.



2. Operatorët e biznesit që heqin nga tregu ushqime, të cilat nuk mund të përdoren për njerëz, kur ato dëmtohen, prishen, skadojnë, nuk shiten ose teprojnë, mund të lidhin një kontratë me një grumbullues, impiant ose stabiliment të licencuar për përpunimin e nënprodukteve shtazore ose/dhe eliminimin e tyre.

3. Operatorët të cilët prodhojnë ushqim për konsum direkt për njerëz, si ushqim i freskët (kuzhina, restorante, mensa dhe operatorë të tjerë të ngjashëm), mund të lidhin një kontratë bashkëpunimi me një operator të licencuar për grumbullimin, përpunimin ose eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore, kur ato nuk depozitohen si mbetje.

4. Lidhja e kontratës sipas pikës 1 të këtij neni është e detyrueshme dhe është kusht i licencimit të aktivitetit primar. Mospajisja me kontratë, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përbën shkak për heqjen e menjëhershme të licencës për ushtrimin e aktivitetit primar.

5. Kontrata sipas kërkesave të këtij neni është pjesë e dokumenteve të licencimit për të gjithë operatorët e biznesit ushqimor.

6. Operatorët e biznesit ushqimor kanë mundësinë të licencohen edhe për eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore, që prodhojnë gjatë procesit të prodhimit ushqimor.

7. Fermat e miratuara lidhin kontratë ose licencohen për përpunimin ose eliminimin e nënprodukteve që prodhojnë, me përjashtim të përdorimit të plehut të stallës për të prodhuar pleh organik, i cili do të përdoret në fermën e tyre pa u tjetërsuar tek të tretët.

8. Operatorët të cilët lidhin kontratë bashkëpunimi me grumbullues dhe përpunues, sipas pikës 1 të këtij neni, por kontrata nuk parashikon marrjen e të gjithë masës së nënprodukteve të prodhuara, janë të detyruar të lidhin edhe një kontratë me një operator të licencuar për eliminimin e nënprodukteve.

9. Kontrata e bashkëpunimit përmban të paktën:

a) kategorinë e materialit, sipas neneve 8, 9 dhe 10 të këtij ligji;

b) mënyrën e transportit të materialeve sipas këtij ligji;

c) marrëveshjen financiare ndërmjet prodhuesit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe

grumbulluesit, përpunuesit ose operatorit që bën eliminimin.

10. Kushtet dhe kriteret për operatorët që përjashtohen nga detyrimet e pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Operatorët të cilët nuk lidhin një kontratë bashkëpunimi me një impiant të licencuar, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk licencohen.

Neni 47

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, si më poshtë:

a) Përdorimi i nënprodukteve shtazore dhe i produkteve derivate në kundërshtim me pikën 1, të nenit 11 të këtij ligji, me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 500 000 (1 milion e pesëqind mijë) lekë;

b) Eliminimi ose përdorimi i materialeve të kategorive 1 dhe 2 në kundërshtim me nenet 12 e 13 të këtij ligji, me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

c) Operatorët të cilët nuk kryejnë markimin e materialeve sipas neneve 12, shkronja “c”, dhe 13, shkronja “ç”, të këtij ligji me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

ç) Mosrespektimi i kërkesave të neneve 21 dhe 22 të këtij ligji me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

d) Operatori i cili vepron në kundërshtim me kërkesat e pikës 1, të nenit 23 të këtij ligji me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

dh) Operatori që vazhdon veprimtarinë kur leja/licenca i është pezulluar ose i është hequr me gjobë nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë lekë);

e) Operatorët që nuk informojnë autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar ose nuk bëjnë përditësimin e licencës sipas pikës 2, të nenit 23 të këtij ligji, me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ë) Lëvizja e nënprodukteve me origjinë shtazore brenda territorit, importi dhe eksporti, të pashoqëruara me certifikatë shëndetësore, të lëshuara nga autoriteti kompetent i kontroleve zyrtare, me gjobë nga 1 500 000 (një milion e



pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë;

f) Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat specifike të transformimit të materialeve të kategorive 1, 2 dhe 3 me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

g) Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat e prodhimit të biogas dhe të kompostit me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

gj) Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat në fushën e higjienës dhe të sistemit të vetëkontrollit (HACCP) me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

h) Operatorët që nuk plotësojnë parametrat standarde të transformimit me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

i) Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat në fushën e përpunimit të nënprodukteve shtazore, sipas përkrahjeve të pikës 1, të nenit 26 të këtij ligji, me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

j) Nëse operatorët fusin në treg nënprodukte shtazore dhe produkte derivate të destinuara për kafshët e mbarështimit pa respektuar kërkesat e nenit 30 të këtij ligji me gjobë nga 1 000 000 (një milion) lekë deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

k) Nëse operatorët fusin në treg dhe përdorin fertilizantë organikë dhe pleh organik pa respektuar kërkesat e nenit 31 të këtij ligji, me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

l) Nëse operatorët fusin në treg ushqim për kafshët e shoqërimit pa respektuar kërkesat e nenit 34 të këtij ligji, me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

ll) Nëse operatorët fusin në treg produkte derivate pa respektuar kërkesat e përgjithshme, sipas përkrahjeve të neneve 35, 36, 37 dhe 38 të këtij ligji, me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

m) Kushdo që fut në treg, importon lëkurë të kafshëve, të cilat i janë nënshtruar një trajtimi mjekësor veterinar të paligjshëm, zorrë të ruminantëve me ose pa përmbajtje, kocka ose produkte me bazë kockat, që përmbajnë kockat e shtyllës kurrizore dhe të kafkës, pa autorizimin

përkatës, me gjobë 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë;

n) Kushdo që importon ose/dhe eksporton nënprodukte shtazore e produkte derivate, me qëllim eliminimin nëpërmjet groposjes ose djegies me gjobë 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Procedura për marrjen e vendimit përfundimtar, lidhur me kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë nen, bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

Neni 48

Metodologjia e përcaktimit të tarifave të tregtimit dhe të eliminimit të nënprodukteve me origjinë shtazore

Metodologjia e përcaktimit të tarifave të tregtimit dhe të eliminimit të nënprodukteve me origjinë shtazore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Neni 49

Ankimi

Subjektet që preken nga masat e marra sipas këtij ligji kanë të drejtën e ankimimit sipas rregullave të parashikuara në ligjin për inspektimet. Në rast mosmarrëveshjeje, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Administrative.

KREU XIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 50

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pikat 1, 2 e 3; nenit 46, pika 10, dhe nenit 48 të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për veterinarinë që brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 21, pika 5; nenit 22, pika 3, dhe nenit 44, pika 2, të tij.



Neni 51

Dispozita kalimtare

1. Operatorët e licencuar për përpunimin, grumbullimin, eliminimin, transportin dhe përdorimin e nënprodukteve shtazore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilët janë licencuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për mjedisin dhe ushqimin, plotësojnë kërkesat e licencimit sipas këtij ligji brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e tij, në rast të kundërt, konsiderohen të palicencuar.

2. Operatorët e biznesit të licencuar për mbarështimin e kafshëve, therjen e kafshëve, mbarështimin e peshkut, përpunimin e peshkut dhe/ose tregtimin e tyre, me qëllim prodhimin e ushqimeve për njerëz, që janë ose përmbajnë produkte shtazore për konsum për njerëz, të cilët nuk përpunojnë nënproduktet shtazore, që ata krijojnë gjatë procesit të mbarështimit ose të prodhimit, lidhin kontratë bashkëpunimi sipas pikës 1, të nenit 46 të këtij ligji, brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Operatorëve, të cilët në kundërshtim me pikën 1, të nenit 46 të këtij ligji nuk lidhin një kontratë bashkëpunimi me një impiant të licencuar, u hiqet licenca për kryerjen e aktivitetit në fushën e biznesit ushqimor.

Neni 52

Shfuqizime dhe ndryshime

1. Në ligjin nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 35/1, 53 dhe 64, të nenit 4 shfuqizohen.

b) Shkronja “d”, e pikës 1, të nenit 53 ndryshohet, si më poshtë:

“d) të ushqyerit e kafshëve të mbarështuara me mbetje, që rrjedhin nga kuzhinat dhe restorantet dhe që përmbajnë proteina me origjinë shtazore, me përjashtim të të ushqyerit të kafshëve që mbarështohen vetëm për prodhimin e gëzofëve, sipas parashikimeve të ligjit, “Për nënproduktet me origjinë shtazore”.”.

c) Shkronjat “e” dhe “ë”, të nenit 53 shfuqizohen.

ç) Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 54 ndryshohet, si më poshtë:

“ç) Organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore krijojnë qendrat e grumbullimit të nënprodukteve shtazore të mbledhura në territorin e tyre dhe lidhin

kontratë me një operator përpunues të licencuar ose me një landfill të licencuar për eliminimin e tyre.”.

d) Shkronja “d”, e pikës 1, të nenit 54 ndryshohet, si më poshtë:

“d) mbledhin kadavrat e kafshëve të shoqërimit të ngordhura të dorëzuara nga qytetarët dhe të kafshëve endacake.”.

dh) Neni 78; pika 2, e nenit 79 dhe neni 80 shfuqizohen.

e) Kudo në ligj fjalët “mbeturina/ve/at me origjinë shtazore” zëvendësohen me fjalët “nënprodukte/ve/t me origjinë shtazore”.

2. Në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fushën II, “Ushqimi dhe shëndeti”, të shtojcës 1 shtohet kategoria nr. 10 e licencës me këtë përmbajtje:

“Grumbullimi, përpunimi, magazinimi, transporti, tregtimi, përdorimi, eliminimi i nënprodukteve me origjinë shtazore, që nuk konsumohen nga njeriu dhe i produkteve derivate.”.

Neni 53

Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi nga data 1 janar 2027.

Miratuar në datën 4.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 359, datë 23.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 359, datë 23.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpallen e ligjit nr. 56/2026, “Për nënproduktet me origjinë shtazore”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**URDHËR****Nr. 119, datë 15.6.2026**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
POLICISË SË SHTETIT DHE
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
GARDËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËR NËNSHKRIMIN E
MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIT
ME KORPORATËN E INVESTIMEVE
SHQIPTARE, NË KUADËR TË
PROJEKTIT TË INVESTIMIT “PËR
ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E
PRONËS SHTETËRORE,
NËNPROJEKTI ‘QENDRA E
SHËRBIMEVE PUBLIKE PALASË’”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të vendimit nr. 321, datë 6.5.2026, “Për transferimin të Korporatave të Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projekteve të investimit ‘Qendra e Shërbimeve Publike Palasë’, ‘Copëzat’”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Partnerit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, z. Skënder Hita, dhe drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, z. Simon Zereçi, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Korporatën e Investimeve Shqiptare, në kuadër të projektit të investimit “Qendra e Shërbimeve Publike Palasë”.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në inventarin e së cilës ndodhen pronat që transferohen sipas marrëveshjes, të ndjekë realizimin e procedurave për vënien në dispozicion dhe dorëzimin e pronave, sipas përcaktimeve të marrëveshjes dhe legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e përfituesit kryesor nga projekti i investimit, të

bashkëpunojnë me Korporatën e Investimeve Shqiptare dhe të ndjekin procedurat e tjera në zbatim të detyrimeve të parashikuara në marrëveshje, përfshirë përcaktimin e nevojave dhe specifikimeve teknike në lidhje me projektin.

4. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, z. Skënder Hita, dhe drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, z. Simon Zereçi, për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Punëve të Brendshme për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

URDHËR**Nr. 121, datë 17.6.2026****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 18.6.2026 deri më datë 19.6.2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, z. Xhemal Qefalia.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

**URDHËR****Nr. 122, datë 17.6.2026****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 23.6.2026 deri më datë 24.6.2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, znj. Silva Caka.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, znj. Silva Caka.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari

KËRKESË**Nr. 191/13, datë 23.6.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 278, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, ‘Sistemi rrugësh, blloku Përroi i Caprazit, Pogradec’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

- Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat/bashkëpronarët e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të përllogaritur për pasurinë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës/listës paraprake bashkëlidhur.

- Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi i kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si dhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Pogradec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

- Vlera totale paraprake e shpronësimit 6,577,857 (gjashtë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë dhe me efekt financiar shtesë 4,511,130 (katër milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I DREJTORISË SË
NEGOCIIMIT DHE ASISTENCËS LIGJORE
Denada Dosti

Page | 12367



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 135]Datë: 26.06.2026 12:54:18
+02:00]9904a834-5634-468c-9f0c-f0ff8f98210b

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)